|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| caktuar në Shtojcë, në Kapitullin 5 të këtij UA.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | the Annex, in Chapter 5 of this AI.                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | Prilogu, u poglavljju 5 ovog AU.                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| <p><b>Neni 11</b><br/><b>Fonti dhe lartësia e shkronjave</b></p> <p>1. Fonti i shkronjave e cila përdoret në shenjat për trashëgimi kulturore dhe turistike është SNV.</p> <p>2. Lartësia e shkronjave përcaktohet në varësi të shenjës dhe llojit të rrugës se ku vendoset shenja.</p> <p>3. Fonti dhe lartësia janë të përcaktuara në Shtojcë, në Kapitullin 5 të këtij UA.</p> | <p><b>Article 11</b><br/><b>Font and size of letters</b></p> <p>1. The font used in signs for cultural and tourist heritage is SNV.</p> <p>2. The size of the letters is determined depending on the sign and the type of road where the mark is placed.</p> <p>3. Font and size are presented in the Annex, in Chapter 5 of this AI.</p> | <p><b>Član 11</b><br/><b>Font i visina slova</b></p> <p>1. Font slova koja se koriste u znakovima kulturne i turističke baštine je SNV.</p> <p>2. Visina slova se određuje u zavisnosti od znaka i vrste puta na kojem se postavlja znak.</p> <p>3. Font i visina su priloženi u Prilogu, u poglavljju 5, ovog AU.</p> |
| <p><b>Neni 12</b><br/><b>Materiali i shenjave</b></p> <p>1. Materialet e tabelës së sinjalizimit të trashëgimisë kulturore dhe destinacioneve turistike duhet të jenë me kualitet të filmit "3M Scotchlite Diamond Grade" – 3MSDG.</p> <p>2. Specifikat tjera janë të përcaktuara në Shtojcë, në Kapitullin 6 të këtij UA.</p>                                                    | <p><b>Article 12</b><br/><b>Sign materials</b></p> <p>1. The materials of the signpost for cultural heritage and tourist destinations should be of the following quality "3M Scotchlite Diamond Grade" - 3MSDG.</p> <p>2. Other specifications are presented in the Annex, in Chapter 6 of this AI.</p>                                   | <p><b>Član 12</b><br/><b>Materijal znakova</b></p> <p>1. Materijali table signalizacije za kulturnu baštinu i turističke destinacije treba da budu kvalitet filma "3M Scotchlite Diamond Grade" – 3MSDG.</p> <p>2. Ostale specifike su priložene u Prilogu, u poglavljju 6, ovog AU.</p>                               |



| Neni 13<br>Specifikat e vendosjes së shenjave                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | Article 13<br>Specifications for placement of signs                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | Član 13<br>Specifike postavljanja znakova                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <p>1. Vendosja e shenjave turistike dhe shenjave tjera duhet të jetë në përputhje me rregullat që rregullojnë planifikimin dhe ndërtimin e objekteve si dhe aktet që rregullojnë sigurinë rrugore.</p> <p>2. Pozita, vendi i vendosjes dhe lartësia e shenjave përcaktohet në mënyrë që sinjalizimi turistik:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>2.1. Të mos i mbuloj shenjat e vendosura të trafikut;</li><li>2.2. Të mos tërheqë vëmendjen nga shenjat e trafikut;</li><li>2.3. Të mos të rrezikoj lëvizjen e këmbësorëve;</li><li>2.4. Të mos jetë e fshehur pamja nga këmbësorëve dhe automjeteve të parkuara.</li></ul> <p>3. Specifikat e vendosjes se shenjave janë të përcaktuara në Shtojcë, në Kapitullin 3 të këtij UA.</p> | <p>1. Placement of tourist signs and other signs should be in accordance with the rules governing the planning and construction of facilities as well as the acts that regulate road safety.</p> <p>2. The position, the placement location and the size of the signs are determined so that the tourist signaling:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>2.1. Will not cover traffic signs;</li><li>2.2. Will not draw away attention from the traffic signs;</li><li>2.3. Will not endanger movement of pedestrians;</li><li>2.4. Will not hide sight from pedestrians and parked vehicles.</li></ul> <p>3. The marking specifications are presented in the Annex, in Chapter 3 of this AI.</p> | <p>1. Položaj turističkih znakova i drugih znakova treba da bude u skladu sa pravilima koja uređuju planiranje i izgradnju objekata, kao i propisima kojima se uređuje bezbednost na putevima.</p> <p>2. Položaj, mesto postavke i visina znakova određuju se tako da turistička signalizacija:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>2.1. Ne pokriva postavljene saobraćajne znakove;</li><li>2.2. Ne skreće pažnju sa saobraćajnih znakova;</li><li>2.3. Ne ugrožava kretanje pešaka;</li><li>2.4. Nije sakrivena od linije pogleda pešaka ili parkiranim vozilima.</li></ul> <p>3. Specifike za postavljanje znakova su priložene u Prilogu, u poglavljju 3, ovog AU.</p> |



|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <p><b>Neni 14</b><br/><b>Specifikat teknike të vendosjes së shenjave</b></p> <p>Specifikat teknike të vendosjes së shenjave janë të përcaktuara në Shtojcë, në Kapitullin 6 të këtij UA.</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | <p><b>Article 14</b><br/><b>Technical specifications for placement of signs</b></p> <p>The technical specifications for placement of signs are presented in the Annex, in Chapter 6 of this AI.</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                              | <p><b>Član 14</b><br/><b>Tehničke specifikacije za postavljanje znakova</b></p> <p>Tehničke specifikacije za postavljanje znakova su priložene u Prilogu, u poglavlju 6, ovog AU.</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| <p><b>Neni 15</b><br/><b>Shtoja</b></p> <p>Shtoja e bashkangjitur këtij Udhëzimi Administrativ është pjesë përbërëse e tij.</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             | <p><b>Article 15</b><br/><b>Annex</b></p> <p>The annex attached to this Administrative Instruction is an integral part of it.</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | <p><b>Član 15</b><br/><b>Prilog</b></p> <p>Prilog priložen ovom Administrativnom uputstvu je sastavni deo istog.</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| <p><b>Neni 16</b><br/><b>Dispozitat kalimtare</b></p> <p>1. Simbolet dhe llojet e shenjave të Trashëgimisë Kulturore dhe turistike janë të përcaktuara në Shtojcën e këtij UA.</p> <p>2. Simbolet që nuk janë të prapara në këtë UA paraprakisht duhet të miratohen nga MKRS ose MTI, varësisht nga lloji i shenjës, të cilave ju përcaktohet përbajtja edhe forma e tyre.</p> <p>3. Pëlqimi për shenjëzim të çdo lloj objekti kulturor merret në MKRS, ndërsa për atraksionet turistike merret në MTI.</p> | <p><b>Article 16</b><br/><b>Transitional provisions</b></p> <p>1. Symbols and types of cultural and tourist heritage signs are presented in the Annex of this AI.</p> <p>2. Symbols that are not foreseen under this AI must be preliminarily approved by the MCYS or MTI, depending on the type of sign, to which their content and form is determined.</p> <p>3. The consent for marking of any type of cultural site is taken from MCYS, while for tourist attractions is taken from MTI.</p> | <p><b>Član 16</b><br/><b>Prelazne odredbe</b></p> <p>1. Simboli i vrste znakova kulturne i turističke baštine su navedeni u Prilogu, u poglaviju 4, ovog AU.</p> <p>2. Simboli koji nisu predviđeni ovim AU trebaju da dobiju preliminarnu dozvolu MKOS ili MTI, u zavisnosti od vrste znaka, za koje se određuje sadržaj i oblik.</p> <p>3. Saglasnost za obeležavanje bilo koje vrste kulturnog objekta se dobija u MKOS-u, dok se za turističke atrakcije u MTI.</p> |



|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <p>4. Pëlqimi për vendosjen e shenjave merret në autoritetin përkatës MI apo Komuna.</p> <p>5. Shenjet e zonës urbane duhet të vendosen më së largu gjashtë (6) muaj nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi administrativ.</p> <p>6. Të gjitha shenjet e vendosura te cilat nuk janë në pajtim me këtë UA, brenda 6 muajve duhet të zëvendësohen me shenja sipas këtij UA.</p> | <p>4. The consent for placement of signs is taken at the relevant authority, MI or the Municipality.</p> <p>5. Signs in urban areas should be placed at the latest six (6) months after the entry into force of this Administrative Instruction.</p> <p>6. All placed marks that do not comply with this AI should be replaced within 6 months with signs in accordance with this AI.</p> | <p>4. Saglasnost za postavljanje znakova se dobija u nadležnom organu MI ili opštini.</p> <p>5. Znaci za urbanu zonu trebaju se postaviti najkasnije šest (6) meseci nakon stupanja na snagu ovog Administrativnog uputstva.</p> <p>6. Svi postavljeni znaci koje nisu u skladu sa ovim AU se trebaju zameniti znacima prema ovom AU u roku od 6 meseci.</p> |
| <p>Neni 17<br/>Hyrja në fuqi</p> <p>Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi tetë (8) ditë pas nënshkrimit nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit.</p>                                                                                                                                                                                                                    | <p><b>Article 17</b><br/><b>Entery into force</b></p> <p>This Administrative Instruction enters into force eight (8) days after being signed by the Minister of Culture, Youth and Sports.</p>                                                                                                                                                                                            | <p><b>Član 17</b><br/><b>Stupanje na snagu</b></p> <p>Ovo Administrativno uputstvo stupa na snagu 8 (osam) dana nakon potpisivanja od strane ministra za kulturu, omladinu i sport.</p>                                                                                                                                                                      |

Kujtim GASHI  
Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit  
Prishtinë, Data: 11/2/2019

Kujtim GASHI  
Minister of Culture, Youth and Sports  
Prishtina, Date: 11/2/2019

Kujtim GASHI  
Ministar Kulture, Omladine i Sporta  
Priština, Datum : 11/2/2019

**SHTOJCA**

# KAPITULLI 1

## 1. SHENJAT TURISTIKE DHE TJERA TË INFORMIMIT


Shenjat turistike janë të dedikuara për informim, gjegjësisht për të drejtar shfrytëzuesin e shërbimeve turistike deri te potencialet turistike dhe përmbytjet e ofertave turistike (në tekst: destinacionet turistike). Shenjat e sinjalistikës turistike janë:

- Shenja "shënim kulturo- historik"
- Shenja "atraksion natyror"
- Shenja "objekt hotelier"
- Shenja "objekt publik"
- Shenja "atraksione turistike"
- Shenja "rrugë turistike"
- Shenja "Mirë se vini" dhe "Lamtumirë"
- Shenja "tabela turistike informuese, për komunikacion, turizëm dhe informacione të tjera turistike"

- **Shenja "shënim kulturo- historik" (VII-3)** tregon drejtimin drejtë monumenteve kulturore ose vendeve historike, përmendoreve ose objekteve të tjera në lagje (p.sh. monumentet e kulturës, tërësitë kulturo- historike, vendet arkeologjike, objektet fetare, bibliotekat, etj).

Shenja ka formë "tabelë udhëtregues turistik", me madhësi të skajeve të shkurtra prej 30 cm, dhe përmban një simbol, deri në dy mbishkrime dhe një shigjetë që tregon drejtimin majtas ose djathtas.

Mbishkrimi ose mbishkrimet duhet shënuar në qendër të shenjës, ndërmjet shigjetës dhe simbolit. Fusha e simbolit është e ndarë me linjë vertikale nga fusha e mbishkrimit:



VII-3



VII-3

Fig. 1.1 Shenja treguese të trashëgimisë kulturore

- Shenja "atraksion natyrorë" (VII-C4) tregon drejtimin e atraksionit natyrorë ose objekteve në vendbanim (p.sh. kopsht botanik, kopsht zoologjik, akuarium, etj.) ose bukurive natyrore apo objekteve në një zonë të mbrojtur.  
Shenja ka formë "tabelë udhëtreguese-turistike", me madhësi të skajeve të shkurtra prej 30 cm dhe përmban një simbol, deri në dy mbishkrime dhe një shigjetë që tregon drejtimin majtas ose djathtas.

Mbishkrimi ose mbishkrimet duhet shënuar në qendër të shenjës, ndërmjet shigjetës dhe simbolit. Fusha e simbolit është e ndarë me linjë vertikale nga fusha e mbishkrimit.



VII – 4

Fig. 1.2 Shenja treguese të atrakSIONeve natyrore

- **Shenja "objekt hotelier" (VII-5)** tregon drejtimin për objektin hotelier të kategorisë së caktuar në rrithinë.

Në shenjë- tabelë shkruhet lloji i objektit (hotel, motel, etj) emri dhe adresa.

Shenja ka formë të " udhëtreguese turistike ", me madhësi të skajeve të shkurtër prej 30 cm, dhe përmban një simbol, një mbishkrim maksimal prej dy fjalësh dhe një shigjetë që tregon drejtimin, majtas ose djathtas. Mbishkrimi ose mbishkrimet duhet shënuar në qendër të shenjës, ndërmjet shigjetës dhe simbolit. Fusha e simbolit është e ndarë me linjë vertikale nga fusha e mbishkrimit.



VII-5



VII-5



VII-5

*Fig. 1.3 Shenjat treguese për objektet hoteliere*

- **Shenja "objekt publik" (VII-6)** tregon drejtimin e objekteve publike në rrithinë (terminale për udhëtarë, qendra sportive- rekreative, spitale, etj).


Shenja ka formë të " udhëtreguese turistike ", me madhësi të skajeve të shkurtër prej 30 cm, dhe përmban një simbol, një mbishkrim maksimal prej dy fjalësh dhe një shigjetë që tregon drejtimin, majtas ose djathtas. Mbishkrimi ose mbishkrimet duhet shënuar në qendër të shenjës, ndërmjet shigjetës dhe simbolit. Fusha e simbolit është e ndarë me linjë vertikale nga fusha e mbishkrimit.



VII-6



VII-6



VII-6

Fig. 1.4 Shenjat treguese për objektet publike

- **Shenja "atraksione turistike"** (VII-1) paraqet shënim kulturorë, historik, atraksion natyrore apo ndonjë objekt. Shenja është në formë drejtkëndëshe dhe përmban emrin e një destinacioni turistik, artistik, grafik ose pamje fotografike me distanca deri te destinacioni turistik. Emri i destinacionit turistik është i shtypur në pjesën e sipërme të shenjës. Largësia nga destinacioni është shtypur në pjesën e poshtme të shenjës, nën simbol. Shenja mund të përfshijë emrat e objekteve, ndërtesave, apo ndonjë shpjegim të detajuar në lidhje me destinacionin turistik. Emrat e objekteve brenda destinacioneve turistike mund të përbajnë edhe një shpjegim të detajuar në lidhje me të, i cili do të jetë i shkruar nën peizazhin artistik, grafik ose fotografik.

Shenja mund tē përbajë simbole të cilat janë tē vendosura nën pamjen artistike, grafike apo fotografike në sfond ose nën emrin e objekteve brenda destinacionit turistik apo një shpjegim më tē detajuar në lidhje me destinacion turistik. Sipërfaqja maksimale e shenjës munde tē jetë  $6 \text{ m}^2$ . Për shkrimin tē destinacioneve përdoren shkronjat e alfabetit latin me lartësinë e shkronjave (H) 140 mm dhe 175 mm.



VII-1

*Fig. 1.5 Formë e tabelave tē shenjave turistike (VII-1)*

- **Shenja "rrugë turistike" (VII-2)** shënon rrugën ose pjesën e rrugës së shpallur si rrugë turistike (p.sh.: panorama e rrugëve, rrugët e verës, shtigje shëndeti, rrugë malore, rrugët e kulturës, shtigjet e biçiklistëve, etj.).

Shenja është në formë drejtkëndëshe dhe përmban mbishkrimin "rrugët turistike" në pjesën e sipërme tē shenjës. Ajo po ashtu përmban simbolin, llojin dhe emrin e rrugës turistike.

Shenja mund tē përfshijë një tabelë, ndërsa sipërfaqja maksimale e shenjës është  $6 \text{ m}^2$ .




Fig. 1.6 Tabela e shenjës "Rrugë turistike" (VII-2)

- Shenjet "Mirë se vini" (VII-7) dhe "Lamtumirë" (VII-8) Shenja "Mirë se vini" ka formë drejtkëndëshe dhe mbishkrim për të shprehur mirëseardhje në hyrje të shtetit, rajon turistik, komunë ose qytet. Shenja mund të përbajë një simbol ose shënim grafik. Shenja për mirëseardhje në shtet përmban mbishkrimin "Republika e Kosovës", emblema e Republikës së Kosovës dhe teksti "Mirë se vini" në \_\_\_\_\_ gjuhën shqipe, serbe dhe të paktën në dy gjuhë të huaja.

Shenja "lamtumirë" është në formë drejtkëndëshe dhe përmban mbishkrimin "Republika e Kosovës " dhe teksti "lamtumirë" \_\_\_\_\_ në gjuhën shqipe e serbe dhe të paktën dy gjuhë \_\_\_\_\_ të \_\_\_\_\_ huaja.

Shenja "Mirë se vini", në regjion, qytet ose regjion turistik është në formë drejtkëndëshe dhe përmban tekstin "Mirë se vini", emri dhe emblema e rajonit apo qytetit, emri i rajonit të udhëtimit, emri i komunës dhe emblema e simbolet.

Shenja "lamtumirë" është në formë drejtkëndëshe dhe përmban mbishkrimin "Lamtumirë", emrin e rajonit, komunës, zona turistike etj.


Sipërfaqja maksimale e shenjave për të shprehur mirëseardhje është:

- 12 m<sup>2</sup> për shenjet të cilat shprehin mirëseardhje vendosen në hyrje dhe dalje të Shtetit ose regjionit.

- $6 \text{ m}^2$  për shenjat të cilat shprehin mirëseardhje vendosen në hyrje dhe dalje të regjionit, regjion turistik ose komunës.



VII-7



VII-8

*Fig. 1.7 Tabelat e shenjave si treguese në hyrje dhe dalje të qytetit*

- Shenja "Tabela turistike informuese, për komunikacion, turizëm dhe informacione të tjera turistike" VII-9) përmban informacion të detajuara të dobishme për turistët nëpër qytet, komuna, zona turistike, vend turistik apo lokalitete turistike.

Informacionet nga paragrafi i mëparshëm i referohen ofertës turistike të qytetit, komunës, zonës turistike, vendeve turistike, apo lokaliteteve turistike. Shenja mund të përbajë informacione të shërbimeve (p.sh. emri, kategori, adresa, telefoni i hotelit; emri, kategori, adresa, telefoni i restorantit dhe emrin, adresën, numrat e telefonave etj.) për përdoruesit e shërbimeve turistike.


Shenja ka formë drejtkëndëshi dhe është e ndarë në dy fusha horizontale. Fusha në pjesën e sipërme të shenjës-tabelës është me një lartësi maksimale prej 40 cm dhe

përmban mbishkrimin "Informacione turistike" në shqip, serb dhe të paktën një gjuhë të huaj. Mbishkrimi është i vendosur në mes të fushës.

Fusha në pjesën e poshtme të shenjës përmban shprehje artistike, grafike, hartografike ose pjesë fotografike dhe informacione të ofertave për turistët në qytet, komunë, zona turistike, vende turistike ose lokalitete turistike.

Nëse shenja gjithashtu përfshin informacione të shërbimeve, ato janë të shënuara në fushë te kjo shenjë. Në këtë rast, sipërfaqja e shenjës do të ndahet në tri fusha gjatësore, në mënyrë që fushat anësore së bashku përbëjnë 1/3 e gjithë sipërfaqes. Informacionet e shërbimeve shtypen në fushat anësore.

Sipërfaqja maksimale e lejuar e shenjës është  $10 \text{ m}^2$  në vendbanim dhe  $20 \text{ m}^2$  jashtë vendbanimit. Përbajtja e informacioneve turistike në tabelë mund të prezantohen në formë elektronike dhe në asnjë rast nuk mundë të jetë e devijuar nga formën e përcaktuar e shenjës me këtë udhëzim.



1 + 2 + 3 + 4 + 5 -- pjesa informuese

6 -- pjesa per sherbime (emri, titulli ose nr. tel. te hotelit, sherbimit etj.)

VII-9

Fig. 1.8 Vendasja e shenjave dhe simboleve në tabelë

Për të shënuar destinacionet turistike përdoren edhe shenjat e sinjalizimit të komunikacionit:

- "udhëtreguesi turistik në formë shigjete";
- "udhëtreguesi turistik në formë të tabelës";
- "tabela e informacioneve turistike ";
- "objekti i dedikuar për shumë qëllime"

Emri i setit që shenjëzohet në tabelë, duhet të jetë në bazë të emrit të tij zyrtar e paraqitur nga Ministria e Kulturës, Rinise dhe Sportit.

## KAPITULLI 2

### 2. FORMA, NGJYRA DHE GJUHA E SHENJAVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE DHE DESTINACIONEVE TURISTIKE PËR INFORMIM

#### 2.1 FORMA

Format e shenjave të trashëgimisë kulturore dhe destinacioneve turistike janë: katrore, katërkendëshe dhe në formë shigjetë.

#### 2.2 NGJYRAT

Ngjyrat e shenjave të destinacioneve turistike përcaktohen vartësisht nga karakteri i tyre, kështu:

- Destinacionet turistike të karakterit lokal ku sfondi i shenjës ka ngjyrë të bardhë ndërsa korniza, mbishkrimi dhe simboli kanë ngjyrë të zezë;
- Destinacionet turistike me rëndësi të jashtëzakonshme ku sfondi i shenjës ka ngjyrë të kaftë (brown) ndërsa, korniza me mbishkrim ka ngjyrë të bardhë, dhe simboli ka ngjyrë të zezë me bazë të bardhë, përveç kur parashikohet ndryshe nga këto udhëzime.

Shenjet e sinjalistikës turistike kanë këto ngjyra:

- Shenja "kulturore- historike e trashëgimisë" ka sfond bazë të shenjës me ngjyrë të kaftë (brown) ndërsa korniza, mbishkrimi dhe shigjeta kanë ngjyrë të bardhë dhe simboli ka ngjyrë kafe (brown) me bazë të shtrirë në të bardhë;
- Shenja "atraksion natyror" sfondin bazë e ka ngjyrë të gjelbër ndërsa korniza, mbishkrimi dhe shigjeta janë të ngjyrës së bardhë dhe simboli ngjyrë kafe (brown) me bazë të shtrirë në ngjyrë të bardhë;
- Shenja "objekt hotelier" ka sfond bazë të shenjës me ngjyrë të kaltër ndërsa, korniza, mbishkrimi dhe shigjeta kanë ngjyrë të bardhë dhe simboli ka ngjyrë të kaltër me bazë të shtrirë në të bardhë;

- Shenja "objekt publik" ka sfond bazë të shenjës me ngjyrë të bardhë ndërsa, korniza, mbishkrimi dhe shigjeta kanë ngjyrë të zezë dhe simboli ka ngjyrë të zezë me bazë të shtrirë në të bardhë;
- Shenjet "atraksione turistike" dhe "rrugë turistike" kanë sfond bazë të shenjës me ngjyrë të kaftë (brown) ndërsa, korniza dhe mbishkrimi kanë ngjyrë të bardhë dhe simbolet janë ngjyrë kafe (brown) me bazë të shtrirë në të bardhë.

Artet grafike ose pamjet fotografike të treguar në shenjë si "atraksione turistike", si dhe artet grafike të treguara në shenjë "rrugë turistike" mund të jetë në më shumë ngjyra:

- Shenjet për shprehjen e mirësjelljes kanë sfond të shenjës me ngjyrë blu ndërsa, korniza dhe mbishkrimi kanë ngjyrë të bardhë dhe simbolet janë me ngjyrë të zezë me bazë të shtrirë në të bardhë;
- Shenjet "tabela turistike informuese, për komunikacion, turizëm dhe informacione të tjera turistike" kanë sfond të shenjës me ngjyrë të bardhë ndërsa, korniza, vijat të cilat ndajnë hapësirat dhe hapësirat në të cilat vendoset teksti "informatë turistike" kanë ngjyrë të kaftë (brown). Teksti "informatë turistike" shënohet me ngjyrë të bardhë. Pamjet grafike, hartografike, peizazhet fotografike dhe informacionet e vendosura mund të jenë në më shumë ngjyra.

Simbolet me të cilat më afër përcaktojnë objektet për të cilat ato lidhen, dhe janë përdorur në shenjet e komunikacionit, i përkasin grupit të simboleve të cilat janë përdorur në grupin e shenjave informuese të komunikacionit, ose grupin e simboleve grafike për përdorim të përgjithshëm. Shenjet mund të përbajnë deri në gjashtë simbole.

Për shënimin e trashëgimisë kulturore- historike dhe objekteve në shenjet e sinjalistikes turistike, në vend të simboleve mund të përdoret pamja fotografike me shumë ngjyra.

Shenjet turistike të informimit duhet të jenë të me tone të ngjyrave të hapura, të ndriçuara dhe në përputhje me shenjet e tjera me të cilat janë të vendosura. Shenjet turistike nuk mund të përdoren për reklamime turistike dhe përbajtje të tjera.

## 2.3 KODI I NGJYRAVE

### *Ngjyra e shenjave me sfond te kaftë:*

Kodi i ngjyrës së kaftë e cila përdoret për shenjat e trashëgimisë kulturore si dhe turistike është PMS (Pentone Matching System) 469. Kodi heksadecimal është #613314 e cila është hije e errët e ngjyrës së portokalltë. Në modelin e ngjyrave RGB (Red-Blue-Green/ Kuqe-Kaltër-Gjelbër) #613314 përbëhet nga 38.04% ngjyrë të kuqe, 20% ngjyrë të gjelbër dhe 7.84% ngjyrë të kaltër. Kjo ngjyrë ka gjatësi valore përafërsisht 605 nm.

### *Ngjyra e shenjave me sfond të kaltër:*

Kodi i ngjyrës së kaltër e cila përdoret për shenjat për shërbime dhe informim për turistë është PMS (Pentone Matching System) 294. Kodi heksadecimal është #003882 e cila është hije mesatare e errët e ngjyrës së kaltër. Në modelin e ngjyrave RGB (Red-Blue-Green/ Kuqe-Kaltër-Gjelbër) #003882 përbëhet nga 0% ngjyrë të kuqe, 21.96% ngjyrë të gjelbër dhe 50.98% ngjyrë të kaltër. Kjo ngjyrë ka gjatësi valore përafërsisht 485 nm.

### *Ngjyra e shenjave me sfond të gjelbërt:*

Kodi i ngjyrës së gjelbërt është PMS (Pentone Matching System) 349. Kodi heksadecimal është #046a38. Në modelin e ngjyrave RGB (Red-Blue-Green/ Kuqe-Kaltër-Gjelbër) #046a38 përbëhet nga 1.57% ngjyrë të kuqe, 41.57% ngjyrë të gjelbër dhe 21.96% ngjyrë të kaltër. Kjo ngjyrë ka gjatësi valore përafërsisht 533.43 nm.

### *Ngjyra e shenjave me sfond të bardhë:*

Kodi i ngjyrës së bardhë sipas PMS (Pentone Matching System) nuk ka kod. Kodi heksadecimal eshte #FFFFFF. Në modelin e ngjyrave RGB (Red-Blue-Green/ Kuqe-Kaltër-Gjelbër) #FFFFFF është i përbërë prej 100% te kuqe, 100% të gjelbert dhe 100% të kaltërt. Kjo ngjyrë ka gjatësi valore përafërsisht 0 nm.

## **2.4 GJUHA**

Teksti në shenja duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe serbe, në pajtim me Ligjin për gjuhë zyrtare ne Republikën e Kosovës, Nr.02/L-37. Krahas tyre, teksti duhet të jetë edhe në gjuhën angleze.

Në nivelin komunal, krahas gjuhëve të përdorura, në tabela duhet të vendoset edhe gjuha e komunitetit tjetër që jeton në atë komunë, në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

Renditja e gjuhëve duhet të jetë shqip, serbisht, anglisht, në bazë të Ligjit për Gjuhët.

## KAPITULLI 3

### 3. VENDOSJA E SHENJAVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE, DESTINACIONEVE TURISTIKE DHE SHENJAVE TJERA PËR INFORMIM

Vendosja e shenjave turistike dhe shenjave tjera duhet të jetë në përputhje me rregullat që rregullojnë planifikimin dhe ndërtimin e objekteve si dhe rregulloret që rregullojnë sigurinë rrugore.

Shenjet për trashëgimi kulturore dhe shenjet turistike vendosen në afërsi të destinacioneve, ose të paktën në udhëkryqin e fundit me rrugën lidhëse që të çon drejt në destinacionin turistik. Për destinacionet e trashëgimisë kulturore dhe turistike me rëndësi të madhe, shenjet mund të vendosen në udhëkryqet e mëparshme si dhe përgjatë drejtimeve rrugore.

Nëse shenjet "tabelë turistike informative", "trashëgimi kulturore" ose "atraksion turistik" i paraprinjë udhëtreguesve ose tabelave informuese të komunikacionit, më së shumti mund të vendosen dy shenja në distanca të ndryshme nga shenjet e rrugëve lidhëse për destinacion turistik të cilit i referohen.

Shenja "rrugë turistike" vendoset në fillim dhe në fund të rrugës ose në pjesë të rrugës e cila është e shpallur rrugë turistike, ose vetëm në fillim të rrugës rrethore.

Shenjet që shprehin mirëseardhje vendosen në:

- Kalimet kufitare në Republikën e Kosovës;
- Kufi të regjioneve në Republikën e Kosovës;
- Pikën e hyrjes në një regjion turistik.

Shenja "tabela turistike informative, për komunikacion, turizëm dhe informacione të tjera turistike" vendoset në pushimore dhe hapësira tjera pranë rrugës të cilat janë dedikuar pushimores. Para tabelës vendoset shenja "Informata" me tabela plotësuese të cilat tregojnë largësinë në metra deri tek vendi ku është vendosur shenja.

Shenjat "trashëgimi kulturore- historike", "atraksion natyror", "objekt hotelier" dhe "objekt publik" përdoren si sinjalizime turistike të destinuara për orientimin e këmbësorëve. Këto shenja vendosen në hapësira të përcaktuara për lëvizjen e këmbësorëve.

Shtylla mbajtëse e shenjës vendoset në distancë prej së paku 2 (dy) m nga shtresa qarkulluese e rrugës (asfaltit). Shtyllat mbajtëse të shenjave mund të konstruktohen dhe të dizajnohen sipas kërkesave dhe stileve të kërkuesve si dhe të mjedisit që i rrethon. Lartësia minimale e shenjave të vendosura nga sipërfaqja e tokës ku lëvizin këmbësorët është 2.20 m.

Pozita, vendi i vendosjes dhe lartësia e shenjave përcaktohet në mënyrë që sinjalizimi turistik:

- Të mos i mbuloj shenjat e vendosura të trafikut;
- Të mos tërheqë vëmendjen nga shenjat e trafikut;
- Të mos të rrezikoj lëvizjen e këmbësorëve;
- Të mos jetë e fshehur pamja nga këmbësorëve dhe automjeteve të parkuara.

Në autostradë nuk lejohet shënimi i destacioneve turistike pavarësisht rëndësisë së tyre, e cila ndodhet në afërsi të autostradës, jashtë vendbanimit, ose për destinacionet për të cilat është ndërtuar një lidhje e veçantë me autostradën.

Përjashtim nga paragrafi i mëparshëm për autostradë mundet të ketë me propozim të organeve përkatëse, ku mund të jenë të shënuara pasuri të trashëgimisë kulturore të një rëndësie të posaçme por të cilat nuk gjenden pranë autostradës. Shenjat turistike të sinjalizimit për hotele e motele vendosen edhe në vendet tjera, aty ku ka vështirësi në vendosjen standarde të tyre. Në vendbanime ku ekzistojnë më shumë hotele dhe motele, me sinjalizim turistik duhet të përfshihen të gjitha hotelet dhe motelet.

Shenjat me të cilat shfrytëzuesit e shërbimeve turistike orientohen drejtë destacioneve turistike të cilat nuk shfrytëzohen për një periudhë të caktuar (p.sh., ski terrenet, plazhet, etj.), në atë

periudhë duhet të largohen ose duhet të jenë të shënuara me tabela plotësuese me të cilat (me fjalë ose me simbol) shënohet qartë në cilën periudhë kohore shfrytëzohet destinacioni turistik. Kjo dispozitë nuk aplikohen për shenja kur ato vendosen në vendbanim.

Monumentet kulturore, bukuritë natyrore, zonat e caktuara, apo destinacione të tjera të cilat sinjalizohen me shenjë të komunikacionit apo shenjë turistike, përvèç kushteve të përcaktuara me specifikacion teknik për rrugë, së paku duhet të plotësojnë edhe këto kushte:

- vendet historike, monument, zonat, ose objektet duhet të jenë të përfshira në listën e mbrojtur të trashëgimisë kulturore dhe natyrore;
- vendet historike, monument, zonat, ose objektet mund të vizitohet rregullisht gjatë gjithë viti;
- rruga dhe qasja në vendet historike, monumentet, zonat ose objekte duhet të jenë të e sigurt dhe lehtësish e qasshme për vizitorët, të së cilëve i është dedikuar;
- duhet të sigurohet numër i mjaftueshëm i vendeve të parkimit për automjete jashtë rrugës;
- duhet të sigurohen nyje sanitare.

Sinjalistika turistike dhe sinjalizimet tjera për informim mund të vendosen edhe në rrithin më të ngushtë të mundshëm, nëse nuk mund të vendosen sipas këtij UA dhe duhet të jenë në pajtim me UA për sinjalizimin dhe rregullat e trafikut rrugor.

Në autostrada dhe rrugët e shpejta (rrugë të rezervuara për automjete motoristike) nuk është e lejuar vendosja e sinjalistikës turistike dhe tjera për informim, përvèç shenjave VII-1 dhe VII-1.1 (tabelave për informim, Fig. 2.2), VII-7 (Mirë se vini në R. E Kosovës), VII-8 (Mirë u pafshim) dhe VII-1.1 (tabela informative turistike).

Shenjet turistike dhe shenjet tjera informuese mund të vendosen vetëm pranë rrugës, nëse rruga qarkulluese dedikohet vetëm për lëvizje të automjeteve motorike. Nëse rruga qarkulluese është e paraparë edhe për trafik të përzier, përvèç automjeteve edhe pjesëmarrësit tjerë në komunikacion të cilët nuk bëjnë pjesë në automjete motoristike, atëherë shenjet turistike dhe shenja të tjera informuese mund të vendosen mbi sipërsfaqen qarkulluese të rrugës.

Shenjat turistike dhe shenja të tjera informuese në rrugë jashtë vendbanimit vendosen në shtylla me lartësi prej 1.5 m nga sipërfaqja e rrugës (asfaltit). Shenjat turistike dhe shenjat tjera informuese në vendbanime, të vendosura së bashku në rrugë ose ndonjë sipërfaqe tjetër të rrugës, lartësinë e shtyllës duhet ta kenë 2.25 m (min 2.1 m) nga sipërfaqja e rrugës ose zonës tjetër të rrugës ku vendosen shenjat.

Lartësia nga paragrafit i mësipërm llogaritet nga sipërfaqja e paraparë për qarkullim të automjeteve deri te skaji i poshtëm i shenjës ndërsa, kur është shenja bazë dhe shenja shtesë atëherë llogaritet deri në fund të tabelës shtesë.

Vendi i vendosjes, lartësia dhe baza- themeli i shenjës turistike dhe shenjave tjera informuese duhet të mos të pengojnë shenjën e trafikut, të mos tërheqin vëmendjen nga shenjat e trafikut, të mos pengojnë lëvizjen e këmbësorëve. Po ashtu, këmbësorët dhe automjetet duhet të mos mbulojnë dukshmërinë e shenjave.

Shtylla e shenjave turistike dhe shenjave tjera informuese sipas rregullit vendosen në largësi deri në 2,00 m nga skaji i asfaltit të rrugës.

Distanca horizontale në mes të skajit të jashtëm të rrugës (cepi i asfaltit) ose skajit të jashtëm të korsisë për ngadalësim dhe skajit më të afërt të shenjës turistike apo shenjës tjetër informuese në rrugët jashtë vendbanimeve duhet të jetë të paku 0.75 m ndërsa, në rrugë me vendbanim së paku 0.30 m, nëse rruga është e kufizuar me kufizues.

Sinjalistika turistike dhe shenjat tjera informuese mund të vendosen ndryshe në këto raste:

- në mbajtëse konzollë, nëse shenja e vendosur në atë mënyrë shihet më shumë nga pjesëmarrësit në komunikacion;
- në shtylla tjera ose konstruksione, nëse ashtu është rregulluar me vendim për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore ose bukurive natyrore.

Shenja informuese kulturore, historike, bukuritë natyrore dhe monumentet VII-1 dhe VII-1.1 (tabelat për informim) mund të vendosen para kryqëzimit (udhëkryqit), vetëm si më poshtë:

- Në autostrada dhe rrugë të shpejta në parim me një distancë së paku 500 m dhe më së shumti 1500 m para tabelës informuese III-8 (tabelë para udhëkryqit- paraprake), ose në qoftë se ajo nuk është, para shenjës III-89 (tabelë udhëtreguese- paraprak);

- Në autostrada dhe rrugë të shpejta mund të vendoset për një dalje nga autostrada vetëm një shenjë VII-1 ose VII-1.1 (tabela për informim). Shenja (shënim kulturo- historik ose atraktioni turistik) e trashëgimisë kulturore ose monument historik për të cilën tabela lidhet nuk guxon të jetë më larg se 30 km nga pika ku vendoset shenja.

Në vazhdim, pjesëmarrësit do të drejtohen vetëm me shenjat rrugore të trafikut në zonën e kryqëzimit për trashëgimi ose monumente, e cila shtohet në shenjën ekzistuese për emrin e vendit ose simbolin, e cila çon në drejtim të monumentit të trashëgimisë kulturore, si:

- Në rrugët kryesore jashtë vendbanimit sipas rregullit në një distancë prej të paktën 250 m para shenjës së parë të trafikut për informim, i cili informon për drejtimin e udhëtimit në udhëkryq;
- Në rrugët tjera jashtë vendbanimeve, zakonisht në një distancë prej së paktën 150 m para shenjës së parë të trafikut për informim, e cili informon në lidhje me drejtimin e udhëtimit në udhëkryq;
- Në rrugët në vendbanime sipas rregullave në largësi së paku 100 m para udhëkryqit.

Në rrugët nga ndarja e mësipërme, vendosja e shenjave të trashëgimisë kulturore është e lejuar vetëm nëse ato i përbushin të gjitha kushtet e këtyre udhëzimeve. Shenjat për informimin e drejimit në të cilin gjenden monumentet e trashëgimisë kulturore, bukuritë natyrore, objektet e rëndësishme brenda zonave që i rrethon ose vendbanimit, mund të vendoset vetëm brenda territorit ose rrëthit sipas ligjit në një distancë prej 30 m para shenjës së parë informuese të trafikut i cili informon për drejtimet e ngasjes në udhëkryq. Nëse në udhëkryq nuk qëndrojnë shenjat e trafikut për rregullimin e komunikacionit në zonën e kryqëzimit, shenjat mund të vendosen para hyrjes në kryqëzim ose në udhëkryq.

Me përjashtim të shenjës VII-3 (tabela për vlera kulturore ose historike, monumente ose objekte në vendbanim), mund të përdoret edhe në rrugët jashtë vendbanimeve për të drejtuar drejt vlerave historike ose objekteve të kulturës, nëse për shënimin e tyre nuk është plotësuar kushti për shënim me shenjat VI-1 ose VII-1.1 (tabela plotësuese për njoftim).

Në rastet kur shenjat për informimin e destinacioneve turistike vendosen jashtë sipërfaqeve qarkulluese (zonat e pushimit- pushimore, auto-parkingjet) dhe zonave të tjera përgjatë rrugës,

të cilat janë caktuar për aktivitetet përcjellëse, ato vendosen në sipërfaqet të cilat nuk janë të destinuara për vozitje të automjeteve e që ofrojnë siguri për këmbësorët.

Paraqitura skematike e vendosjes së shenjave:

Shenjet paraprake në formë drejtkëndëshi duhet të vendosen në një distancë prej 300-400 m nëse shpejtësia në atë pjesë është më e madhe se 80 km/h, ndërsa përafërsisht 200m nëse shpejtësia është 80 km/h ose më pak.

Më poshtë është paraqitur vendosja e shenjave në rrugët nacionale ose regionale në lidhje me rrugë lokale. Nëse atraksioni gjendet afër rrugës shtetërore ose regionale, atëherë shenja vendoset në distancë më pak se 5 km ndërsa, deri në maksimum 10 km për një atraksion të rëndësishëm regional.





Fig. 2.1 Paraqitura skematike e vendosjes së shenjave



*Fig. 2.2 Paraqitja skematike tabelave plotësuese*

Tabelat plotësuese janë: tabela shtesë VII-1.1 që tregojnë distancën ndërmjet shenjës dhe vendit ku është referuar shenja. Shenja plotesuese shënohet me fjale, numra ose shigjeta për drejtimin dhe largesinë. Sipërfaqeja është e bardhë, mbishkrimi i zi ndërsa, korniza e zezë në të gjitha rastet.

### **3.1 ATRAKSIONET NË RRUGËT LOKALE**

Nëse ndonjë atraksion gjendet në rrugët lokale, atëherë shenjat në formë të shigjetës duhet të vendosen sa më afér udhëkryqit, por jo me afér se 25 m nga shenja ekzistuese e trafikut dhe vendoset mbrapa shenjës së trafikut, edhe nëse rruga është në lidhje me ndonjë rrugë nacionale ose regionale.

Nëse rekreacioni turistik është i vendosur në rrugë komunale, shenjat në formë shigjete duhet të vendosen:

- Në kthesën prej rrugës më të afërt kryesore deri te rruga lokale për te atraksioni, nëse distanca e atraksionit është më e vogël se 2 km në zonat e ndërtuara ose më pak se 10 km në zonat rurale;
- Në cilëndo kthesë të rrjetit rrugor lokal.

## KAPITULLI 4

### 4. SIMBOLET DHE LLOJET E SHENJAVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE DHE DESTINACIONEVE TURISTIKE

Simbolet e shenjave të trashëgimisë kulturore dhe destinacioneve turistike janë si në vazhdim:




E 1.1

Muze




E 1.2

Shtëpi



E 1.3

Teqe




E 1.4

Xhami




E 1.5

Kishë Katolike




E 1.6

Katedrale




E 1.7

Kala



E 1.8

Kullë



E 1.9

Hamam




E 1.10

Kishë ortodokse



E 1.11

Mulli i ujit




E 1.12

Lum



E 1.13

Liqe




E 1.14

Grykë




E 1.15

Fontanë



E 1.16

Urē




E 1.17

Krua/ Shatërvan




E 1.18

Ujvarë




E 1.19

Verari




E 1.20

Bibliotekë




E 1.21

Pronë nacionale




E 1.22

Muze i agrikulturës



E 1.23

Muze i hekurudhave




E 1.24

Fermë



*E 1.25*

*Kopshti i zogive*




*E 1.26*

*Kinema*



*E 1.27*

*Teater*




*E 1.28*

*Galeri e artit*




*E 1.29*

*Rezervat i kafshëve të egra*



*E 1.30*

*Kopsht zoologjik*



*E 1.31*

*Tuneli*




*E 1.32*

*Sipërfaqe kulturore*




*E 1.33*

*Digë*




E 1.34

Hapësirë për studimin e natyrës




E 1.35

Shkollë



E 1.36

Mejtep, Medrese




E 1.37

Tyrbe




E 1.38

Sahatkullë



E 1.39

Hambar




E 1.40

Tumë ilire




E 1.41

Shpellë



E 1.42

Kosh



E 1.43

Ndërtesë historike




E 1.44

Manastir




E 1.45

Gjykatë




E 1.46

Bunar




E 1.47

Përmendore



E 1.48

Varreza



E 1.49

Stacion i trenit



E 1.50

Vendbanim romak



E 1.51

Lokalitet arkeologjik




E 1.52

Sinagoga




E 2.1

Kënd për ndezje zjarri




E 2.2

Vend kampingu



E 2.3

Vend karavanesh




E 2.4

Vend për ushqim dhe pije



E 2.5

Vend për akomodim




E 2.6


Informim për turistë



E 2.7



E 2.8




E 2.9

Simboli për orientim në  
parking për turistë

Simboli për orientim për shërbim  
të ndihmës së shpejte ose spitalit

Postë



E 2.10

Pompës së benzinës



E 2.11

Vendndalje e autobusit



E 2.12

Hapësirë për pirje të duhanit



E 3.1

Vend pikniku



E 3.2

Tokë me drunjë –  
hapësirë rekreacioni



E 3.3

Park zbatitës



E 3.4

Kalërim



E 3.5

Kënd lojrash




E 3.6

Stadium



E 3.7

Gjuajtje me hark



E 3.8

Aktivitete sportive ujore



E 3.9

Oendra sportive për not



E 3.10

Aktivitete lundruese – kajak



E 3.11

Vend për peshkim



E 3.12

Zhytje



E 3.13

Skijim në ujë



E 3.14

Vozitje me varkë



E 3.15

Hapësire rekreacioni dimëror



E 3.16

Vend për patinazh



E 3.17

Ecje me shputa në borë



E 3.18

Vendi për teleferik



E 3.19

Vend për paraglide



E 3.20

Ecje malore – bjeshkatari



E 3.21

Vend për skijim



E 3.22

Pushtim i majeve malore



E 3.23

Shteg i çiklizmit rekreativ



E 3.24

Ngjitje në shkëmbinj




E 3.25

Shteg i çiklizmit malor



3.26

Vizitë në shpellë



E 3.27

Pamje panoramike

*Fig. 3.1 Simbolet e shenjave të trashëgimisë kulturore dhe destinacioneve turistike*

Shenjat udhëzuese për zonën me interes kulturor si dhe rekreacion duhet të janë në formë katrore ose drejtkëndore dhe simboli ose mbishkrimi duhet të jetë më ngjyrë të bardhë në një sfond ngjyrë kafe (brown).

## **4.1 KODI DHE NUMRI I SIMBOLIT**

Të gjitha simbolet identifikohen me kodin dhe numrin e tyre. Ndarja e simboleve bëhet në tre grupe dhe secili grup ka numrin bazë identifikues me shkronja dhe numrin rendor.

Kodet ndahen në:

- E 1.x– simboli i trashëgimisë kulturore
- E 2.x – simboli për shërbime
- E 3.x– simboli për rekreacion

Numrat shënohen prej 01 deri 99 për secilën kategori të sinjalizimit.

## KAPITULLI 5

### 5.1 DIMENSIONET E SHENJAVE SIPAS LLOJIT TË TABELAVE

Varësisht nga vendosja e tyre, shenjat kanë dimensione të ndryshme. Kështu, nëse simbolet vendosen si piktogramë në kuadër të tabelave, atëherë dimensionet e tyre janë 20 cm x 20 cm.




Fig. 4.1 Dimensionet e simboleve të cilat vendosen si piktogramë në tabelë

Ndërsa, nëse vendosen si të veçanta në rrugë, pra në një shtyllë vetëm një shenjë, atëherë në bazë të shpejtësisë vendosen në këto dimensione:

- Përmasat e shenjave kulturore duhet të jenë 60 x 60 cm. Aty ku nevojitet dukshmëri më e madhe, duhet të përdoren madhësi më të mëdha. Zgjerimet e shenjës duhet të jenë në rritje prej max. 15 cm;
- Përmasat e shenjave kulturore duhet të jenë 80 x 80 cm kur përdoren në autostrada (në raste të veçanta) ose në motoudhë;
- Përmasat më të vogla prej 40 x 40 cm, mund të përdoren në rrugët me shpejtësi më të vogël, me volum më të ulët dhe jashtë rrugës.




Fig. 4.2 Dimensionet e shenjave të cilat vendosen në shtylla

Dimensionet e tabelave duhet të vendosen si në figurën e mëposhtme:




Fig. 4.3 Dimensionet e tabelave

A – gjerësia e tabelës (4 m<sup>2</sup> – në regjionale, 0.5 m<sup>2</sup> – brenda qytetit)

B – lartësia e tabelës

H - lartësia e shkronjës së madhe në varësi prej kategorisë së rrugës

h - lartësia e shkronjës së vogël e cila është (5/7 H)

m – (6/7 H) distanca në mes shkronjës së parë dhe kornizës së parë të tabelës

d – gjerësia e vijës së kornizës së tabelës

D – gjerësia e komplet shigjetës

e – dimensionet e simbolit i cili duhet të jetë 20cm x 20cm, në varësi prej vendit të vendosjes si dhe shpejtësisë së rrugës

c1 – (4/7 H) distanca prej cepit të shigjetës deri te skaji i parë i kornizës së tabelës

k – distanca prej skajit të tabelës deri të vija e brendshme e tabelës

U2 – (5/7 H) distanca prej fundit të shigjetës deri te korniza e tabelës

Y – gjatësia e tabelës

O – (5/7 H) distanca në mes të shkronjave në pjesën e sipërme deri te korniza e tabelës

O2 – (4/7 H) distanca prej cepit të shigjetës deri te mbishkrimi

## 5.2 LARTËSIA H (mm) DHE FONTI I SHKRONJAVE

| LLOJI I RRUGËS                | LARTËSIA E SHKRONJAVE H (mm) |
|-------------------------------|------------------------------|
| Autostradë                    | 210                          |
| Rrugë nationale (magjistrale) | 175                          |
| Rrugë regjionale              | 140                          |
| Rrugë lokale                  | 104                          |

Fonti i shkronjave e cila përdoret në shenjat për trashëgimi kulturore dhe turistike është SNV.

Shenjat e trashëgimisë kulturore varësish nga kategoria e rrugëve ndryshojnë vetëm në madhësi, duke u mbështetur në lartësinë e shkronjave.

Tabelat në formë të shigjetës mund të vendosen në gjatësi prej 130, 160 dhe 190 cm në varësi nga gjatësia e rreshtit ndërsa gjerësia e tabelës nuk ndryshon, pra 30cm. Kur simboli vendoset në formë të pikrogramit duhet të vendoset me dimensione 20cm x 20cm. Lartësia e shkronjave në gjuhën shqipe është 8cm ndërsa, në dy gjuhët tjera, për arsyet e hapësirës dhe gjatësisë së rreshtit është 5cm. Nëse në tabelën shigjetë tregohet së destinacioni gjendet në anën e djathtë atëherë shigjeta duhet të jetë në anën e djathtë ndërsa, simboli në anën e majtë, kurse mbishkrimi në mes. Më poshtë janë dhënë disa variante se si të vendoset mbishkrimi në tabelat me shigjetë:





Fig. 4.4 Dimensionet e tabelave në formë të shigjetës

Në rastin kur gjatësia e tekstit është e madhe, në mes të tekstit në gjuhën shqipe me tekstin në dy gjuhët tjera vendoset vija ndarëse. Simboli vendoset pa kornizë, ndërsa teksti shkruhet në mes shigjetës dhe simbolit për të cilin është dhënë informimi (fig. 4.5).




Fig. 4.5 Tabela në formë të shigjetës

Varianti në vazhdim paraqet kombinimin e shenjave turistike me shenjat për shërbimet që shënohen me sfond me ngjyrë të kaltër si në fig. 4.6:




Fig. 4.6 Kombinim i simboleve në një tabelë informuese

Në rastin kur duhet të vendosen disa shenja në një shtyllë, mund të përdoren tabelat e mëposhtme ku përsëri janë dhënë dy variante, gjithashtu me dimensione të njejtë të lartpërmendura fig.4.7:




Fig.4.7 Tabelë e shenjave të trashëgimisë kulturore në formë drejtkëndore me shigjetë

Nëse vendosen dy ose më shumë tabela të kategorisë së njejtë në të njëjtën shtyllë, atëherë merr këtë formë fig.4.8:




*Fig. 4.8 Forma e vendosjes së dy ose më shumë tabelave në të njëjtën shtyllë*

Ndërsa, në rastin kur në një shtyllë mund të vendosen disa tabela të formave të ndryshme, atëherë merr këtë formë fig.4.9:



*Fig. 4.9 Vendosja e disa tabelave në një shtyllë në të dy anët e shtyllës*

Tabela në fig. 4.10 ka ngjyrë të kaltër meqë në të janë të vendosura simbolet për shërbime për turistë. Këto tabela kanë sfondin e kaltër ndërsa simbolin e bardhë. Në këto shenja mund të hyjnë: shenjat për akomodim, hapësira për camping dhe karavanë, qendra e informimit për vizitorë, kafetë dhe restauranet, stacioni i shërbimeve, toaletet publike, hapësirat e pushimit, shërbimet për ndihmë të shpejtë si dhe hapësirat për parking.



*Fig. 4.10 Tabela për vendosjen e simboleve për shërbime për turistë*


Krahas tabelave të përmendura, janë edhe tabelat trashëgimi kulturore si dhe te turistëve të cilat u shërbejnë këmbësorëve dhe paraqiten në këtë formë:

- Forma e parë (fig. 4.11) paraqet rastin kur shënohet minutazhi i ecjes në këmbë deri në destinacion:




*Fig. 4.11 Tabela e këmbësorëve kur në të paraqitet minutazhi i ecjes në këmbë  
deri tek destinacioni*

- Forma e dytë (fig. 4.12) paraqet rastin kur mbishkrimi në tabelë është i gjatë, ose në rastin kur dëshirojmë të vendosim sa më pak tabela të këmbësorëve në rrugë, apo përfshirjen e më shumë simboleve në një tabelë:



*Fig. 4.12 Tabela e këmbësorëve kur në të paraqiten më shumë simbole*

Vendosja e këtyre shenjave bëhet në distancë prej minimum 0.3 m nga cepi i rrugës deri tek cepi i parë i shenjës ndërsa, maksimum 2.0 m deri në mesin e shtyllës së shenjës.



*Fig. 4.13 Distanca e vendosjes së shenjave nga cepi i rrugës*

Lartësia e shenjës në hapësirat e qytetit është minimum 2.1 m ndërsa, në hapësirat rurale minimum 1.5 m.



Fig. 4.14 Lartësia e vendosjes së shenjës në hapësira të ndryshme





Fig. 4.15 Vendosja e me shumë tabelave ne një shtyllë



*Fig. 4.16 Vendosja e tabelave ne dy shtylla*

Mënyrat e vendosjes së tabelave në bazë të llojit të terrenit:





Fig. 4.17 Vendosja e tabelave në bazë të llojit të terrenit

## KAPITULLI 6

### PËRSHKRIMI TEKNIK I SINJALIZIMIT PËR TRASHËGIMI KULTURORE DHE DESTINACIONE TURISTIKE

#### 6.1 ELEMENTET E SHENJAVE

Elementet bazë të sinjalizimit të shenjave janë:

- Shenjet e trashëgimisë (tabela/ pllaka);
- Mbajtësit e shenjave (shtyllat e formave të ndryshme dhe të përpunuara);
- Pjesët për përforcimin e tabelës në shtyllën mbajtëse

Pajisjet montuese për shenjet e trashëgimisë duhet të konsiderohen si pjesë përbërëse të shenjave informuese në trafikun rrugor. Forma dhe madhësia e shenjave janë të caktuara në mënyrë detale sipas Ligjit mbi Sigurinë e Komunikacionit Rrugor. Madhësia e shenjave të trashëgimisë kulturore dhe të tjera varet nga lloji i rrugës.

Madhësia (gjerësia) e shenjave plotësuese (pllakave) të shenjave të trashëgimisë kulturore dhe tjera duhet t'i përshtatet madhësisë së shenjës të cilën e plotësojnë.

##### 6.1.1 PLLAKA E PRAPME

Plakat e prapme e shenjave duhet të jetë e punuar nga:

- *Poliesteri nga fijet e qelqit, ose*
- *Plaka metalike (llamarinë e hekurit ose e aluminit)*

##### 6.1.2 PAJISJET MONTUESE

Pajisjet montuese për shenjet e trafikut (lidhëset, bulonat, ribatinat dhe shajbnet) duhet të jenë nga metali.

## **6.2. KUALITETI I MATERIALIT**

### **6.2.1. MATERIALI I THEMELEVE**

Kualiteti i betonit të përdorur për themele të pajisjeve inxhinierike të trafikut anësorë dhe mbi rrugë është i detajuar sipas kushteve të posaçme teknike. Betoni që duhet të përdoret është MB 10 ose 15. Pasi që gypat e betonit kryesisht shërbejnë për themelet e parafabrikuara të mbajtësve, kualiteti i tyre duhet të jetë konform kualitetit të betonit të caktuar për themele.

## **6.3 STRUKTURAT MBAJTËSE**

### **6.3.1 MBAJTËSIT**

Mbajtësit e shenjave të trashëgimisë dhe trafikut duhet të jenë të punuara nga gypat metalike  $\varnothing$  60 mm (për pajisjet e rrugëve lokale) dhe  $\varnothing$  64 mm (për pajisjet e rrugëve kryesore), me trashësi të mureve jo më të vogël se 2.0 mm, dhe me mbrojtje të brendshme dhe të jashtme me galvanizim në të nxehëtë ose me ndonjë metodë tjetër adekuate (mveshje plastike, ngjyrosje, metalizim).

## **6.4 MATERIALI I TABELËS**

Gjatë periudhës së përdorimit të shenjave të trashëgimisë kulturore dhe shenjave informuese, forma dhe ngjyra e shenjave nuk duhet të ndryshohet apo të humbet, ashtu që të mund të tregojë në mënyrë të drejtë dhe të qartë drejtimin dhe informacionin për pjesëmarrësit në trafik. Materialet e ndryshme të cilat mund të kombinohen për shenjat e trashëgimisë kulturore dhe të tjera duhet të mbisin kompatibile në të gjitha temperaturat dhe kushtet klimatike, ashtu që të sigurohet qëndrueshmëria e tyre.

Materialet e përdorura për shenjat e trashëgimisë kulturore dhe të tjera informuese duhet të jenë të qëndrueshme në:

- ndikimin e kushteve klimatike dhe rezistente ndaj ujit;
- ndërrimet e cilësive klimatike;
- kushte klimatike dhe kohëzgjatje;
- zjarr dhe rreziqe të ngjashme.

#### **6.4.1 PLLAKA E PRAPME**

Plakëtë e prapme duhet të jetë në gjendje që të pranojë ndërrimet e temperaturës mes  $-35^{\circ}\text{C}$  dhe  $70^{\circ}\text{C}$ . Lëvizjet e tillë të lejuara të temperaturës, të cilat janë brenda kufijve të elasticitetit të materialit, deformimet elastike nuk duhet ta zvogëlojnë qëndrueshmërinë e shenjave të trafikut.

Trashësia e plakës së prapme të shenjës varet nga:

- madhësia e caktuar e shenjës;
- lloji i materialit;
- metoda e profilimit dhe përforcimit.

Llamarina e plakës së prapme nuk duhet të jetë më e vogël se 2 mm.

#### **6.4.2 CILËSIA E MATERIALIT TË TABELAT DHE MBISHKRIMET**

Vlerat e kufizuara të cilësive kalorimetrike dhe fotometrike të materialeve për plakave të prapme, shenjave, porosive me fjalë dhe pjesës së prapme të shenjave të trashëgimisë kulturore dhe shenjave tjera të trafikut janë të caktuara në Ligjit mbi Sigurinë e Komunikacionit Rrugor.

Për caktimin e dukshmërisë ditore të ngjyrave, ndriçimi relativ duhet të konsiderohet si faktori kryesor dhe për retro- reflektueshmërinë e dukshmërisë gjatë natës. Ngjyrat me shkëlqim nuk duhet të përdoren për shenja të trashëgimisë kulturore dhe shenja tjera informuese, me qëllim të evitimit të shkëlqimit verbues të drithave të automjeteve.

Vetëm ngjyrat adekuate mund të përdoren për shenja e trashëgimisë kulturore dhe lyerjet mbrojtëse të mbështetësve të shenjave në rrugët publike. Nëse nuk shfrytëzohet ana e prapme e shenjave të trashëgimisë kulturore dhe shenjave tjera (përfshirë të gjitha mjetet për montim) atëherë ajo duhet të ngjyrosat me ngjyrë të hirtë (gri).

Ngjyrat dhe foljet (materialet) e shenjave të trashëgimisë kulturore, sikurse ato të trafikut duhet të jenë rezistente ndaj materialeve të cilat përdoren për pastrimin e tyre.

Ngjyrat e përdorura për shenjat e trashëgimisë kulturore duhet të ngjiten mirë për plakën e prapme. Materialet retro-reflektuese, vetitë fotometrike të cilave gjatë kohës së përdorimit të

tyre mund tu reduktohen më tepër se përgjysmë sipas vlerave minimale të kërkuara për materialet e reja, nuk mund të përdoren për shenja të trafikut dhe mbishkrimet në shenjat e trafikut. Për foljet reflektuese të klasës së parë kërkohet qëndrueshmëria prej 7 viteve.

#### **6.4.3 PAJISJET PËR MONTIM**

Pajisjet për fiksimin e shenjave të trashëgimisë kulturore dhe informuese për strukturat mbajtëse duhet të punohen nga materialet e tilla të cilat sigurojnë se funksionimi i tyre i destinuar do të arrihet në mënyrë adekuate gjatë periudhës së përdorimit, dhe që mundësojnë ndërrimin e shenjave të trashëgimisë kulturore dhe shenjave informuese.

Shtrëngesat dhe shajbnet duhet të punohen nga trarëzat adekuate metalike ndërsa, bulonat dhe dadot, nga hekuri i kualitetit të lartë.

#### **6.4.4 METODA E MONTIMIT**

Si pajisjet anësore ashtu edhe shenjat e trashëgimisë kulturore të vendosura mbi rrugë, duhet të vendosen në lokacionet e caktuara sipas projektit dhe sipas rregullores së aplikueshme.

#### **6.4.5 PUNIMI I THEMELEVE**

Gërmimi i themeleve për tabela të mëdha dhe shenja anësore të vendosura mbi rrugë duhet të kryhet sipas kushteve të caktuara, dhe mbushja e prapme e themeleve të gërmuara duhet të bëhet në përputhje me kushtet e caktuara të posaçme teknike.

Metoda e detajuar e punimit të themeleve, sipas dimensioneve të propozimit duhet të aprovohet nga inxhinieri mbikëqyrës i cili mund t'i përcaktojë kushtet plotësuese të cilat duhet të mbikëqyren gjatë kryerjes së punëve për themele.

#### **6.4.6 PLLAKA E SHENJAVE**

Shenjat e trashëgimisë kulturore mund të jenë të njëanshme apo të dyanshme. Në raste të posaçme, pllaka adekuate e prapme mund të përbajë disa shenja të trashëgimisë kulturore ose informuese. Me një mbajtës të vetëm, në të njëjtën kohë nuk mund të montohen më tepër se dy shenja të trashëgimisë kulturore të dimensioneve të vogla dhe pllakës plotësuese.

Sipërfaqja e pllakës duhet të jetë e rrafshët, e lëmuar dhe e mbyllur, dhe refleksioni i lejuar i saj nuk duhet ta zvogëlojë mundësinë e dallimit të shenjës dhe të porosisë me fjalë. Për zvogëlimin e refleksionit të shenjës dhe kontrastit mes shenjës dhe prapavijës, shenjat e trashëgimisë kulturore duhet të pozicionohen në këndin prej  $85^\circ$  deri  $87^\circ$  me vijën qendrore (tërthorazi me boshtin e rrugës).

#### 6.4.6.1 PAJISJET PËRCJELLËSE PËR MONTIM

Shtrëngueset për montimin e shenjave të trashëgimisë kulturore dhe informuese duhet të jenë të profiliuara si vijon:

- Të mbërthyera ose të salduara për pllakën e prapme; ose
- Të fiksuara me bulona.

Fiksimi i shtrëngueseve nuk duhet të jetë i dukshëm nga ana ballore e shenjës. Metoda e montimit të shenjës duhet të sigurojë pozicion të kënaqshëm në të gjitha kushtet e përdorimit.

#### 6.4.7 KUALITETI I EKZEKUTIMIT

Sa i përket kualitetit të ekzekutimit të shenjave dhe pajisjeve anësore të vendosura mbi rrugë duhet të aplikohen kushtet e caktuara.

Shenjat dhe pajisjet anësore të vendosura mbi rrugë në tërësi, dhe materialet e veçanta, duhet t'i kenë dimensionet brenda kufijve të lejuara edhe nëse u janë ekspozuar ngarkesave të ndryshme mekanike. Lejohet ndryshimi i dimensioneve prej  $\pm 2\%$  nëse nuk është ndryshe e caktuar nga inxhinieri mbikëqyrës.

Pajisjet për montimin e shenjave të trashëgimisë kulturore, sikurse shenjave të trafikut duhet të jenë në gjendje që të pranojnë:


- Forcën vertikale prej 7.5 MN
- Forcën horizontale prej 3 MN

### **6.5.1. MATERIALI I PLLAKËS**

Materialet e tabelës/ pllakës e sinjalizimit të trashëgimisë kulturore duhet të jenë me kualitet të filmit “3M Scotchlite Diamond Grade” – 3MSDG.

### **6.5.2 PËRBËRJA E SHENJAVE**

Tabela e shenjave duhet të punohen nga materiali i përcaktuar duke plotësuar kriterin e qëndrueshmërisë dhe të reflektimit. Renditja e shtresave të shenjave duhet të jetë si në figurën e mëposhtme:



*Fig. 5.1 Përbërja e shenjës*

Zakonisht tabelat janë të punuara nga materiali alumin i fortë. Tabela prej aluminit është peshë e lehtë dhe mund të transportohet nga një vend në tjetrin pa kompromentuar dëmtim. Ky lloj materiali është ideal për rrugë sepse është rezistent ndaj ujit dhe ndryshkut.

Këto shenja duhet të jenë reflektuese pasi që nuk kanë gjasa të ndriçohen nga drita e automjeteve. Retro- reflektiviteti arrihet ose duke përfshirë rruaza qelqi në material ose duke formuar prizma të vogla në plastikë, prandaj janë të njoitura edhe si fletë mikroprizamtike.






Fig. 5.2 Shtresat e shenjave

### 6.5.3 DETALI I VENDOSJES

Vendosja e shenjave të bëhet sipas detaleve të prezantuara në figurat në vijim:

**Detali i vendosjes**



*Fig. 5.3 Mbajtësi i shenjave*

### Detali i fundimit




Fig. 5.4 Detali i fundimit

Në një shtyllë mund të vendosen dy shenja dhe dy tabela plotësuese. Mënyra e vendosjes së shenjave varet nga lloji dhe qëllimi i vendosjes. Në figurën e mëposhtme janë disa raste kur në një shtyllë vendosen nga dy shenja:




Fig. 5.5 Vendosja e dy shenjave në një shtyllë

Distanca e vendosjes nga cepi i rrugës për këto shenja është treguar në figurën e mëposhtme:





Fig. 5.6 Distanca e vendosjes së shenjës nga cepi i rrugës

Me rastin e vendosjes së tabelës, përveç tjerash duhet pasur parasysh edhe këndin e vendosjes i cili duhet të jetë si në figurën në vijim:






Fig. 5.7 Këndi nën të cilin duhet vendosur sinjali

## *Referencat*

1. “Tourist Signing Guidelines”, The Hon Tim Pallas MP Minister for Roads and Ports, The Hon Tim Hoaling MP Minister for Tourism and Major Events, February 2009.
2. “Cumbria Brown and White Tourism Signs”, Cumbria County Council, July 2015.
3. “Procedure for consideration of brown and white tourism signs”, Essex County Council.
4. Verkehrszeichen Befestigungstechnik.
5. “The Manual on Uniform Traffic Control Devices (MUTCD) for Streets and Highways”, U.S. Department of Transportation, Federal Highway Administration, 2009 Edition.
6. “Tourist signs for commercial tourist attractions on statecontrolled roads (white lettering on brown background)”, State of Queensland (Department of Transport and Main Roads), August 2013
7. “Smjernice za projektovanje, građenje, održavanje i nadzor na putevima”, Sarajevo/Banja Luka, 2005.
8. <http://encycolorpedia.com>
9. “Universal Signage Recommendation”, Nasbla Paddlesports Committee.
10. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Web – Faqja.
11. <http://www.bremicker-vt.de/en/products/traffic-signs/general-information-traffic-and-road-signs>
12. <https://www.azdot.gov/business/engineering-and-construction/traffic/manual-of-approved-signs/recreational-and-cultural-interest-signs>
13. “VERTIKALNA PROMETNA SIGNALIZACIJA”, Meblo Signalizacija.
14. “Tourist Signposting”, Transport roads and Maritime Services.
15. Zakon o prometu na cestama R. Hrvatske